



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

RREGULLORE
MBI TATIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME, PËR VITIN 2020

Dragash, 27.11.2019

Në bazë të Ligjit nr. 06 / L-005 - Për tatimin e pasurive të paluajtshme, neni 1, neni 9 dhe neni 12, si dhe Ligji nr. 03 / L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, sipas Propozimit të Drejtorit për Ekonomi, Financa, Buxhet dhe Zhvillim, Kuvendi Komunal i Dragashit, pas shqyrtimit paraprak, në seancën e dt.27.11.2019, miratoi këtë:

RREGULLORE

MBI TATIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME

PËR VITIN 2020

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore vërtetohet tatimi në pronën e paluajtshme, si dhe rregullat dhe procedurat bazë për menaxhimin me pasurin e paluajtshme nga ana e komunës së Dragashit, për vitin 2020.

Neni 2

Fusha e veprimit

Dispozitat e kësaj Rregullave janë të detyrueshme për të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit dhe Rregulloreve, për personat që janë tatimpagues të tatimit në pronë, si dhe për personat tjerë të cilët janë të detyruar të përmbushin detyrimet ligjore në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Neni 3

Të hyrat dhe shpenzimet

Të hyrat nga tatimi në pronë, paguhen në llogarin e komunës në baze të nenit 4. të Ligjit, dhe shfrytëzohet për nevoja të komunës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi rreth financave të pushtetit lokal. Të hyrat, në përgjithësi, shpenzohen për ndërtim dhe zhvillim të infrastrukturës të lagjeve në komunë.

Neni 4

Lirohen nga tatimi në pronë

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të cilët janë përmendur në Nenin 10 të Ligjit të Tatimit në Pronën e Paluajtshme janë të liruar nga pagesa e tatimit në pronë të paluajtshme.

Neni 5

Baza Tatimore

5 a) Për vitin 2020, për pronat rezidenciale (të banimit), vlera u përcaktua nga Ministria e Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2018 - Për metodologjinë e vlerësimit të pasurisë, Raport mbi vlerësimin e përgjithshëm për objekte rezidenciale është pjesë e bashkangjitur e kësaj rregullore.

5 b) Për pronat komerciale dhe industriale, vlerësimi dhe vlera për m^2 është përcaktuar nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim të komunës së Dragashit, në bazë të vlerës së tregut m^2 për këto objekte, duke përdorur metoda të vlerësimit të mëhershëm, dhe vlerësimi sipas zonave është si në vijim:

I. Pronat komerciale dhe industriale

Kategoriya e Vlerësimit	Nivelet e vlerave për- €/m ²										
	Zona I	Zona II	Zona III								
1.Pronë komerciale											
1.1. Shitore	500	400	400								
1.2. Zyrë	500	400	400								
1.3. Restorant	500	400	400								
1.4. Hotel	500	400	400								
1.5. Objekt për magazinim komercial	450	400	300								
1.6. Garazh komercial	100	80	80								
1.7. Pishinë për shfrytëzim komercial	100	80	80								
1.8. Fushë e hapur sportive	45	40	40								
1.9. Fushë e mbyllur sportive	60	60	60								
1.10. Pompë benzine	500	400	400								
1.11. Objekt tjetër komercial	500	400	400								
2. Pronë industriale											
2.1. Fabrikë	300	250	250								
2.2. Punishte	100	80	80								
2.3. Objekt për magazinim industrial	300	250	250								
2.4. Objekt tjetër industrial	300	200	200								

Neni 6

Zonat tatimore

2.1. Në komunën e Dragashit janë identifikuar tre zona për objekte komerciale dhe industriale :

2.1.1 Zona e parë: Përfshin qendrën e gjërë në qytezën e Dragashit.

2.1.2 Zona e dytë përfshin fshatrat: Bellobrad, Bresanë, Blaq, Brezne, Brod, Brrut, Buçe, Buzez, Gllloboçicë, Kapre, Kosavë, Krushevë, Kuk, Kuklibeg, Kukuljanë, Ljubovishtë, Mlikë, Pllavë, Radeshë, Rapçë, Restelicë, Shajne, Vraniç, Zapluxhe, Zgatar, Zym.

2.1.3. Zona e tretë përfshin fshatrat: Pllajnikë, Baçkë, Dikancë, Orçushë, Krstec, Leshtanë, Zlipotok, Rrencë dhe Xërxe.

Neni 7

Normat Tatimore

Në bazë të Ligjit nr. 06/L-005, mbi Tatimin e Pronës së Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Dragash, cakton normat tatimore për vitin 2020 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike, si vijon:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore parcela	0,15%
Për njësitë bujqësore objekte	0,15%
Për njësitë pyjore parcela	0,15%
Për njësitë rezidenciale parcela	0,15%
Për njësitë rezidenciale objekte	0,17%
Për njësitë komerciale parcela	0,20%
Për njësitë komerciale objekte	0,20%
Për njësitë industriale parcela	0,18%
Për pronat industriale-objekte	0,18%

Neni 8

Në bazë të vendimit nr. 32/2019 të datës 24.10. 2019 Ministria e Financave ka liruar nga pagesa të gjithë tatimpaguesit nga pagesa e tatimit për parcelat bujqësore për vitin 2020, për shkak të sqarimit të Ligjit.

Neni 9

Për të gjitha detajet dhe sqarimet në lidhje me tatimin në pronë, që nuk janë të përfshira në këtë Rregullore, konsultohuni me dispozitat e Ligjit për Tatimin e Pasurive të Paluajtshme nr. 06 / L-005 të datës 26.01.2018.

Neni 10 Shfuqizimi

Me këtë Rregullore, shfuqizohet Rregullorja 01 Nr.060/01-29651/1 e dt.30.11.2018.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal të Dragashit.

01 Nr.060-29687/1
Dt.27.11.2019
Dragash

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Betim Merdiu

The seal is circular with a double border. The outer border contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top and 'KOMUNA E DRAGASH' at the bottom. The inner border contains 'KUVENDI KOMUNAL' at the top and 'DRAGASH' at the bottom. In the center, there is a map of the Dragash municipality.